



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE**

**Nr. i Dokumentit: 22.1.1-2016-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT  
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMUNËS SË  
MITROVICËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR  
MË 31 DHJETOR 2016**

**Prishtinë, qershor 2017**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Mitrovicës në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit Imer Vitija dhe anëtarët e ekipit, Kreshnike Haziri dhe Shefkije Beka, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të auditimit Zuke Zuka.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	15
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	29
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	30
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak .....	32
Shtojca IV: Letërkonfirmimi .....	38

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të komunës së Mitrovicës për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit<sup>1</sup>, të datës 20.10.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Më gjerësisht, shih Shtojcën 1 të këtij raporti.

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas mendimit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore paraqesin një *pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

#### Theksimi i çështjes

Si theksim të çështjes dëshirojmë të përmendim faktin se Komuna e Mitrovicës nuk ka arrit t'i regjistroj pasurinë e plotë, tokën dhe objektet në pronësi të saj.

Për avansin e paguar në shumën prej 369,438€ në emër të bashkëfinancimit të projektit KSV/018<sup>2</sup>, nuk është pranuar raporti specifik për progresin e punëve të kryera si një kundërvlerë e pagesave deri me 31.12.2016.

Për më gjerësisht, shih kapitullin 1.1 të këtij Raporti.

<sup>1</sup> Termi "Plani i Jashtëm i Auditimit" është zëvendësim i termit "Memorandumi i Planifikimi të Auditimit"

<sup>2</sup> KSV/018- "Mbështetje institucionale dhe teknike për sistemin e furnizimit me ujë, në rajonin e Mitrovicës"

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Kryetarin e komunës dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



### **Përgjigja e Kryetarit të Komunës**

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna. Më tutje Kryetari i Komunës është zotuar që:

- ta shqyrtoj Raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- deri në fund të muajit janar 2018, ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PFV 2017 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

# 1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.1 Opinioni i Auditimit

### Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të e Komunës së Mitrovicës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

### Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

### Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se, komuna edhe më tutje nuk ka arrit t'i regjistroj të gjitha tokat dhe objektet në pronësi të saj. Kjo, për arsyen se komisioni për vlerësimin e pasurisë nuk ka përfunduar akoma verifikimin dhe vlerësimin e drejtë dhe të plotë të të gjithë pasurive që janë në pronësi të komunës. Si rezultat i mos regjistrimit të pronave në regjistrat e kadastrit dhe në

---

pronësi të komunës, konstatuam se shkollat, objekti i QMF-së dhe ndërtesa e kuvendit komunal nuk figurojnë në regjistrin e pasurisë së komunës. Pajisja sipas regjistrit me numër 6374- e regjistruar si SCOPIA me vlerë 120,000€, nuk kishte ndonjë dokument që tregon pronësinë, pra nuk mund të verifikohet nëse pasuria i takon komunës dhe ekzistencën fizike të saj.

Përveç kësaj, komuna ka paguar avans vlerën prej 369,438€ Lux Dev-it, në emër të bashkëfinancimit të projektit KSV/018 "Mbështetje institucionale dhe teknike për sistemin e furnizimit me ujë, në rajonin e Mitrovicës". Komuna si kundërvlerë për këtë pagesë deri më 31.12.2016, nuk ka pranuar raporte specifike mbi progresin e punëve të kryera. Po ashtu, komuna nuk ka qenë e përfshirë në monitorimin e progresit të punëve të parapara me marrëveshje. Pagesat në regjistrat kontabël janë regjistruar si investime në vijim.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të**

Kryetari i Komunës së Mitrovicës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.



Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me plotësime dhe ndryshime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Në kontekst të PFV-ve, çështjet në lidhje me kornizën raportuese nuk ishin adresuar me rastin e përgatitjes së draft Pasqyrave financiare, ku kemi identifikuar mos-pajtueshmëritë në vijim:

- Neni 14, Raporti i ekzekutimit të buxhetit, shënimi 9 dhe 10;
- Neni 25, Raporti i numrit të punëtoreve;
- Neni 26, Raporti i të punësuarve jashtë listës së pagave; dhe
- Neni 27, Raporti i të punësuarve me kontratë për shërbime të veçanta.

Pas sugjerimeve tona, pasqyrat financiare janë korrigjuar. Megjithatë, sa i përket shpalosjes së pasurive, vlera e tyre në PFV mbetet e nënvlerësuar, pasi që komuna ende nuk është në gjendje t'i regjistroj dhe vlerësoj në mënyrë të plotë tokën dhe objektet e saj. Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë, përveç shpalosjes së drejtë të pasurive.

## 1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjet e sipër përmendura jepet rekomandimi:

**Rekomandimi 1** Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjeve, të ndërmerr veprime në adresimin e shkaqeve të mos arritjes së regjistrimit dhe vlerësimit e të plotë të pasurisë, dhe të sigurohet se komuna do të pranoj kundërvlerën për avancet e paguara sipas Marrëveshjes së Bashkëfinancimit për projektin KSV/018.

---

## 2 Qeverisja

### Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për Komunën e Mitrovicës, që të menaxhoj në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të siguroj ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo është një tregues nëse menaxhmenti po i përmirëson proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vet-vlerësimit që plotësohet nga Organizatat Buxhetore (OB) siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një OB të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Procedurat e një qeverisjeje të mirë kërkojnë që si aktivitetet strategjike, edhe ato operationale të zbatohen dhe monitorohen në mënyrë efektive. Ne kemi vlerësuar ekzistimin e Planit Zhvillimor Komunal 2009-2025 si dhe aprovimet e disa nga planet tjera në sektorë të ndryshëm, të aprovuara nga Kuvendi Komunal. Ne vlerësojmë ndikimin e këtyre planeve në qeverisje të mirë, duke sugjeruar ndërlidhshmërinë e të gjitha planeve sektoriale me Planin Zhvillimor Komunal.

Lista kontrolluese e vet-vlerësimit, e plotësuar nga ana e komunës, e pasqyron një situatë më pozitive duke u bazuar në dëshmi. Mirëpo, procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut ende nuk janë vendosur.

Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi i auditimit të brendshëm të cilësisë së lartë, mbeten ende sfiduese për komunën.

---

## 2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2015 të komunës ka rezultuar me 25 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen rekomandimet. Ne vlerësojmë se menaxhmenti ende ka nevojë të forcoj procesin e llogaridhënies së menaxherëve në zbatimin e rekomandimeve.

Deri në përfundimin e periudhës së auditimit 2016, pesë (5) rekomandime ishin zbatuar, dhjetë (10) ishin në proces dhe dhjetë (10) nuk ishin adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

---

### Çështja 2 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

**E gjetura** Nga paragrafi më lart shihet se pjesa më e madhe e rekomandimeve të vitit të kaluar nuk janë zbatuar, sepse komuna nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar veprimet e marra në zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm.

**Rreziku** Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe kanë rezultuar në:

- menaxhim të dobët të pasurive komunale;
- kontrolle jo adekuate në prokurim;
- rritja e obligimeve të pranuar krahasuar me zotimin e mjeteve;
- dobësitë procedurale në menaxhimin e të hyrave vetjake; dhe
- rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme.

**Rekomandimi 2** Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin e plotë të rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, dhe nga ta të pranoj raporte të rregullta për progresin e rekomandimeve kundrejt planit të veprimit.

---

## 2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të plotësuar nga komuna, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për çështjet më poshtë. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit, por do të pasqyroj gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

---

### Çështja 3 - Pyetësi i vet-vlerësimit - Prioritet i lartë

**E gjetura** Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponenta. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Pyetësi i vet-vlerësimit të plotësuar nga komuna ka vërtetuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut nuk ishin ende funksionale;
2. Proceset efektive të monitorimit si dhe strategjia gjithëpërfshirëse e planit zhvillimor komunal dhe planeve tjera operative, konsiderohen si të vendosura. Çështjet e raportimit po ashtu janë shqyrtuar më hollësisht në nënkapitullin 2.5.3; dhe
3. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore kërkon një rishikim më gjithëpërfshirës, pasi që obligimet për projekte dhe pagesat direkte nga Thesari (përmbaruesit) janë në rritje si pasojë e mungesës së mjeteve.

**Rreziku** Aranzhimet e dobëta të qeverisjes i dobësojnë proceset strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

**Rekomandimi 3** Kryetari duhet të siguroj se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës së rreziqeve, forcimin e çështjeve tjera menaxhuese dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë aktive.

## 2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna e Mitrovicës operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

### 2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Organizatrat buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës. Komuna për mes kuvendit ka aprovuar strategjitë dhe planet e veprimit siç janë: Strategjia e Zhvillimit Ekonomik për Mitrovicën 2014-2017; Strategjia dhe Plani i Veprimit Rinor Lokal 2014-2017; Plani i studimit të fizibilitetit, Planin për zhvillimin e turizmit lokal në Shalë të Bajgores; Planin anti korrupsion 2016-2018; Planin komunal të efikasitetit të energjisë 2014-2020; dhe programin tre vjeçar të banimit 2016-2019. Për të gjitha planet dhe strategjitë parashihen të jenë nënë përkujdesjen e kryetarit të komunës.

### 2.3.2 Raportimi Menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

## Çështja 4 - Kontrollat menaxheriale - Prioriteti i mesëm

<b>E gjetura</b>	Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të komunës ka nxjerrë në pah dobësitë në nivelet e kontrolleve. Si të tilla, aranzhimet e përgjithshme të kontrolleve kërkojnë forcim, në veçanti në lidhje me: planifikimin dhe realizimin e buxhetit në investime kapitale, regjistrimet dhe raportimet e pasurive, pranimit të punëve të realizuara si kundërvlerë e avanseve të paguara dhe mungesa në kontrollet e çertifikimit të pagesave.
<b>Rreziku</b>	Mos aplikimi efektiv i kontrolleve nga menaxhmenti, redukton aftësinë për të reaguar me kohë dhe menaxhuar në mënyrë aktive aktivitetet e komunës, dhe për të përballuar në mënyrë të suksesshme sfidat ekzistuese.
<b>Rekomandimi 4</b>	Kryetari duhet të siguroj se cilësia e kontrolleve dhe mbikëqyrjes buxhetore të rishikohet në mënyrë sistematike për të siguruar se janë vendosur kontrolle të përshtatshme në fushat ku janë identifikuar dobësitë.

---

## 2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre auditorë, duke e përfshirë edhe drejtorin e njësisë. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të komunës dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm (AB) duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet i Auditimit efektiv. Komiteti i auditimit ka mbajtur katër takime në vitin 2016, dhe nga procesverbalet e takimeve vërehet se janë shqyrtuar raportet e auditorit brendshëm.

NjAB ka planifikuar dhe ka kryer 11 auditime. Raportet e auditimit kanë trajtuar fusha të ndryshme dhe janë përfunduar me kohë. Po ashtu, NJAB kishte përgatitë planin strategjik dhe vjetor të auditimit, raporte tre mujore, të cilat i ka dërguar edhe në Njësinë Qendrore Harmonizuese.

---

### Çështja 5 - Zbatimi i pamjaftueshëm i rekomandimeve të NJAB-së - Prioritet i lartë

- |                      |  |
|----------------------|--|
| <b>E gjetura</b>     | Menaxhmenti i komunës nuk kishte bërë plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NJAB për periudhën nën auditim. Komiteti i auditimit gjatë vitit ishte takuar 4 herë, kishte komentuar raportet e auditimit përgjithësisht, dhe ka nxjerrë konkluzione për menaxhmentin, se çfarë veprimesh duhet të ndërmerret për zbatimin e rekomandimeve. Megjithatë, nuk janë vërejtur veprime konkrete. |
| <b>Rreziku</b>       | Mos hartimi i planit të veprimit nga menaxhmenti për adresimin e rekomandimeve të dala nga NJAB, rrit rrezikun që dobësitë e identifikuar të mos korrigjohen, dhe të njëjtat të përsëriten.  |
| <b>Rekomandimi 5</b> | Kryetari duhet të ndërmarr veprime konkrete për përpilimin e planit të veprimit për rekomandimet e AB dhe të kërkoj nga bartësit përgjegjës të cilëve u janë adresuar rekomandimet që edhe formalisht të raportojnë mbi zbatimin e atyre rekomandimeve.  |

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

#### Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, edhe më tutje kontrollet mbi çertifikimin e pagesave nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Fushat tjera ku nevojiten më shumë përmirësime janë planifikimi buxhetit, borxhet, menaxhimi i qiradhënieve, menaxhimi i kontratave (hyrjes në obligime konform mjeteve të disponueshme dhe të zotuar), menaxhimi i projekteve me bashkëfinancime si dhe menaxhimin e pasurive.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	2,267,582	2,267,582	1,995,219	1,517,742	1,645,625
Gjobat e policisë	0	0	67,772		
Gjobat e gjykatave	0	0	36,730		
<b>Totali:</b>	<b>2,267,582</b>	<b>2,267,582</b>	<b>2,099,721</b>	<b>1,517,742</b>	<b>1,645,625</b>

Nga të hyrat e planifikuara prej 2,267,582€ për vitin 2016, ishin inkasuar 2,099,763€ apo 93%. Këtu janë përfshirë edhe gjobat e gjykatave dhe dënimet e policisë. Ky nivel i inkasimit të të hyrave është pozitiv dhe i përafërm me atë planifikuar. Krahasuar me vitin e kaluar shihet një rritje e të hyrave për 581,979€.

Megjithatë, planifikimi i të hyrave nga tatimi në pronë kishte diferencë të ndjeshme krahasuar me realizimin. Komuna për vitin 2016 ka faturuar 819,907€, dhe kishte inkasuar 777,166€, ndërsa sipas ligjit të buxhetit ka planifikuar vetëm 350,000€. Këto mospërputhje flasin për një planifikim jo real të komunës në këtë fushë.

Shuma e të hyrave vetjake ishin lejuar të shpenzohej për investime kapitale, mallra e shërbime, komunali dhe subvencione.

**Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>3</sup>	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>15,948,321</b>	<b>16,932,293</b>	<b>16,285,762</b>	<b>17,367,291</b>	<b>15,051,981</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	13,680,739	14,014,986	13,980,967	15,773,053	13,477,762
Të bartura nga viti paraprak <sup>4</sup> -		291,631	291,289	255,570	125,102
Të hyrat vetjake <sup>5</sup>	2,267,582	2,267,582	1,755,799	1,230,437	1,391,035
Donacionet e brendshme		246,499	175,151	68,547	45,270
Donacionet e jashtme		111,595	82,555	39,684	12,812

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 983,972€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve vendore dhe të jashtme, të hyrave të bartura nga viti paraprak, si dhe i rritjes së aplikuar pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë. Në vitin 2016, në total komuna ka përdorur 96% të buxhet final, me një përmirësim prej 2% krahasuar me vitin 2015.

**Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>15,948,321</b>	<b>16,932,293</b>	<b>16,285,762</b>	<b>17,367,291</b>	<b>15,051,981</b>
Pagat dhe Mëditjet	11,182,774	11,560,023	11,485,848	11,262,513	10,299,754
Mallrat dhe Shërbimet	1,214,439	1,347,708	1,337,968	1,427,375	1,565,467
Shërbimet komunale	465,000	372,356	354,108	446,348	344,815
Subvencionet dhe Transferet	545,043	610,995	589,308	625,418	816,527
Investimet Kapitale	2,541,065	3,041,211	2,518,530	3,605,637	2,025,418

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

Pavarësisht rritjes së buxhetit për projekte kapitale (vendim i Qeverisë 983,977€), niveli i ekzekutimit ishte 83% nga shuma e planifikuar. Ndërsa në kategoritë tjera, niveli i ekzekutimit të buxhetit kishte trend të lartë (mbi 90%). Megjithatë, çështje e rëndësishme për vëmendje lidhur me ekzekutimin e buxhetit janë edhe pagesat përmes vendimeve gjyqësore nga kategoria e investimeve kapitale (271,734€), për shkak që komuna ka hyrë në obligime pa zotimet e mjaftueshme të mjeteve.

<sup>3</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>4</sup> Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>5</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.



---

### 3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e planifikuara për vitin 2016 ishin në vlerë 2,267,582€, kurse realizimi nga të hyrat tatimore dhe jo tatimore ishte 2,099,721€. Këto të hyra kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat administrative, të hyrat nga qiratë dhe të hyrat nga lejet e ndërtimit.

---

#### Çështja 6 - Taksat e regjistrimit të veprimtarisë së biznesit - Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna nuk ka të planifikuar të hyrat nga ushtrimi i veprimtarisë së biznesit, edhe pse për vitin 2016 kishte faturuar bizneset në vlerë totale 177,220€, ndërsa ka inkasuar 21,433€.

Për sa i përket bizneseve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre, komuna disponon listën në një program në Excel, por nuk ka siguri se lista mund të jetë e plotë në mungesë të komisioneve për identifikimin e bizneseve të reja dhe atyre që janë shuar e që vazhdon t'i mbajë në regjistra. Komuna, nuk e bën faturimin e rregullt mujor për secilin obligues dhe se fatura lëshohet në momentin e kërkesës për pagesë nga biznesi.

**Rreziku** Baza jo e plotë e të dhënave me ushtruesit e veprimtarisë së bizneseve, mungesa e komisioneve përkatëse për identifikimin e bizneseve të shuara apo të regjistruara rishtazi dhe mos planifikimi i të hyrave nga kjo fushë, rrit rrezikun për keq menaxhim në evidentimin dhe mbledhjen e të hyrave nga komuna.

**Rekomandimi 6** Kryetari duhet të sigurohet që të bëhet një plan për inkasimin e të hyrave nga taksat e biznesit duke faturuar çdo biznes në baza të rregullta mujore, të sigurohet që lista të jetë e përditësuar me bizneset aktive që ushtrojnë veprimtari dhe të aplikohen masa konkrete për zvogëlimin e të arkëtueshmeve të akumuluar ndërsa vite.

**Çështja 7 - Taksat e mësimit joformal - Prioritet i lartë**

- E gjetura** Shkolla e mesme e ulët “Hasan Prishtina” deri në afatin e qershorit ka vazhduar të inkasoj të hyra duke u bazuar në një rregullore të vjetër e cila është në kundërshtim me rregulloren e brendshme për tarifa dhe ngarkesa nr. 07/2013, duke i ngarkuar 62 kandidat me tarifa jo reale<sup>6</sup>.
- Rreziku** Ngarkesa për kandidatët duke mos u bazuar në rregulloren aktuale për tarifa dhe ngarkesa, rritë rrezikun që aplikantët të dëmtohen financiarisht dhe të mos respektohet rregullorja për arsimin e mesëm joformal.
- Rekomandimi 7** Kryetari i komunës duhet të sigurohet që rregulloret aktuale janë në zbatim në mënyrë që të bëhen ngarkesat e tarifave drejtë duke evituar mundësinë e gabimeve, njëkohësisht të rishikoj rastet e tilla dhe të konsideroj trajtimin e gabimeve të kaluara.

**Çështja 8 - Dobësitë në menaxhimin e lejeve të ndërtimit - prioritet i lartë**

- E gjetura** Komuna lëshon lejet e ndërtimit sipas ligjit të ndërtimit numër 04/L-110 dhe cakton taksën administrative të rekomanduar nga ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Në tri raste komuna nuk kishte respektuar afatin ligjor prej 30 dhe 45 ditëve për shqyrtimin e lëndëve për dhënien ose refuzimin e lejes së ndërtimit. Në një rast leja ndërtimore ishte dhënë me pesë (5) muaj vonesë, tjetri me tre (3) muaj vonesë dhe për shtëpi individuale me katër (4) muaj vonesë.
- Në anën tjetër, komuna ka pajisur aplikuesin me leje ndërtimi pa paguar taksat komunale, pa ndonjë vendim të vlefshëm që justifikon dhënien e lejes.
- Rreziku** Mos respektimi i afatit ligjor për shqyrtimin e aplikacioneve për lejet e ndërtimit, rrit rrezikun që aplikantët të shfrytëzojnë heshtjen administrative dhe të fillojnë ndërtimet pa leje dhe në kundërshtim me planin urbanistik, dhe si rrjedhojë komuna mund të mos arrij planin e inkasimit të të hyrave.
- Pajisja me leje ndërtimore pa i kryer obligimet ndaj komunës është në kundërshtim me ligjin e ndërtimit, dhe për pasojë, të mos inkasohen tarifat e përcaktuara me rregulloren e komunës, si dhe qytetarët të ndihen të diskriminuar për shërbimet e njëjta.
- Rekomandimi 8** Kryetari duhet të sigurohet se afatet e caktuara kohore janë duke u zbatuar sipas ligjit të ndërtimit. Aplikuesit duhet të pajisen me leje të ndërtimit ose refuzimit brenda afateve të parapara me ligj. Gjithashtu, kontrolle të shtuara duhet të vendosen për të siguruar që asnjë leje e ndërtimit nuk do të lëshohet nëse paraprakisht nuk janë kryer obligimet ndaj komunës.

<sup>6</sup> Sipas rregullores 07/2013 për arsimin e mesëm joformal, tarifa është 150€ derisa pagesat janë bërë 205€.

**Çështja 9 – Dobësitë në menaxhimin e pronave publike - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Në komplekset banesore të dhëna me qira për familjet e dëshmorëve dhe rastet sociale (36 familje), gjendjet e shfrytëzuesve dhe kontratat nuk janë verifikuar nga viti 2011. Siç parashihet në kontrata, çdo dy vite duhet të formohen komisione nga Kuvendi Komunal që të verifikohet gjendja sociale e shfrytëzuesve dhe në bazë të raportit të tyre t'u vazhdohet ose ndërpritet kontrata. Si rezultat kontratat nuk konsiderohen valide në mungesë të verifikimeve, edhe pse shfrytëzohen nga të njëjtat familje. Borxhi i identifikuar nga komuna për këto raste (47,701€) konsiderohet jo real, sepse nga 2012, nuk ka pasur ngarkesa për shfrytëzuesit dhe borxhi i identifikuar i takon periudhës deri në 2011. Banka Pro Credit, shfrytëzon pronën komunale për operimin e veprimtarisë së saj nga viti 2015 me kontratë të skaduar. Ndonëse për vitin 2016 kishte borxh të mbetur 1,189€. Nga komuna nuk është dhënë arsyetimi për këtë çështje.

Po ashtu, bizneset të cilat shfrytëzojnë hapësirat publike gjatë sezonave të caktuara, nuk monitorohen rregullisht dhe si rrjedhojë nuk përmbushin obligimet ndaj komunës. Sipas regjistrave që posedon komuna borxhet e deritanishme janë 1,039€.

**Rreziku** Mungesa e kontrolleve adekuate nga komuna lidhur me shfrytëzimin e pronës publike rrit rrezikun që këto prona të keqpërdoren, të rritet borxhi ndaj komunës dhe mjetet e parapara të mos inkasohen asnjëherë.

**Rekomandimi 9** Kryetari duhet të ndërmarr masat që sa më parë t'i pajisë qiramarrësit me kontrata në mënyrë që të kenë bazë ligjore të shfrytëzimit të pronave komunale dhe të merr masa konkrete për inkasimin e të gjitha borxheve të mbetura nga qiratë. Po ashtu, të ngarkohen me taksë të gjithë shfrytëzuesit e pronave komunale. Në të kundërtën, komuna duhet të ndërmarr hapa që pronat e njëjta t'u jep në shfrytëzim qiramarrësve të përgjegjshëm.

**3.1.2 Pagat dhe mëditjet**

Buxheti për kategorinë e pagave dhe mëditjeve për vitin 2016 ka qenë i planifikuar 11,560,023€, ndërsa është shpenzuar 11,485,848€.

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: a) kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave, b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin. Ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e pagesave, rekrutimet, largimet, punët jashtë orari dhe kontratat për shërbime te veçanta.

---

Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës dhe kemi ngritur çështjet që janë paraqitur më poshtë:

---

#### **Çështja 10 - Kontratat për shërbime të veçanta - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Për kryerjen e aktiviteteve në administratën komunale dhe për shërbime të parkingjeve, komuna kishte angazhuar 15 punëtorë me kontratë për shërbime të veçanta. Një pjesë e tyre në administratën komunale janë zyrtarë financiar, dhe ushtrojnë detyrat në pozita të rregullta. Komuna nuk ka zhvilluar procedura të thjeshtësuara për rekrutim, siç kërkohet me UA.

**Rreziku** Mosrespektimi i procedurave të rekrutimit me marrëveshje për shërbime të veçanta, rrit rrezikun për punësimin e personelit pa kritere për pozitën e caktuar. Mbulimi i pozitave të rëndësishme (administratë komunale) me kontrata për shërbime të veçanta mund të rezultojë në performancë të dobët dhe pasiguri në angazhimin e stafit adekuat.

**Rekomandimi 10** Kryetari i Komunës duhet t'i rishikoj nevojat reale për angazhim të punëtorëve me kontrata për shërbime të veçanta. Kjo çështje duhet të trajtohet në mënyrë serioze dhe nevojat për staf shtesë për pozitat e rregullta të parashikohen me rastin e planifikimeve buxhetore.

#### **Çështja 11 - Pagesat për punë jashtë orari (kujdestari) - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Nga katër mostra të testuara të pagesave jashtë orari (QKMF), tri prej tyre nuk janë të kompletuara me vendime, dëshmi mbështetëse për pagesën apo nuk ka vendim për kompensimin e punëve jashtë orarit. Përveç kësaj, në disa raste tjera, në emër të kujdestarisë janë kompensuar edhe zyrtarë në komisione të caktuara apo edhe kontabilisti për punë jashtë orari.

Të gjitha pagesat për punë jashtë orari dhe komisioneve janë paguar në emër të kujdestarive përmes sistemit të pagave.

**Rreziku** Pagesat për punë jashtë, orari në formë të kompensimeve paraqesin një gjendje jo reale të shpenzimeve të pagave, dhe mos mbulimi i punës jashtë orari paraqet rrezik se paraja publike e taksapaguesve nuk po shpenzohet si duhet.

**Rekomandimi 11** Kryetari i komunës duhet të ndërmerr veprime për sa i përket vendimeve që merren dhe të jenë në përputhje me dispozitat ligjore, si dhe të vlerësojnë nevojat dhe pagesat për punë jashtë orari, duke e respektuar nenin 13 dhe nenin 40.2 të Ligjit për administrimin e pushtetit lokal dhe dispozitat e tjera ligjore relevante.

### 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 1,720,064€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,692,076€. Ato kanë të bëjnë me furnizim me pajisje dhe inventar, materiale të zyrës, shërbime kontraktuese, derivate etj.

#### Çështja 12 - Furnizime jashtë kontratës - Prioritet i lartë

**E gjetura** Për projektin "Furnizim me material mjekësor laboratorik, stomatologjik dhe furnizim me pajisje laboratorike të mjekësisë familjare dhe barna", është përcaktuar menaxheri i projektit dhe është përgatitur plani për menaxhimin e kontratës. Megjithatë, në dy pagesa ka artikuj që nuk janë paraparë me kontratë. Në pagesën prej 1,697€ janë shtuar tre artikuj në vlerë prej 331€, si dhe në pagesën e dytë prej 11,471€ janë paguar tre artikuj në shumë prej 5,120€, që në total arrijnë vlerën 5,451€.

**Rreziku** Furnizimet me artikuj jashtë kontrate dhe mungesa e mbikëqyrjes adekuate në pagesa kundrejt kontratës, mund të sjellë humbje financiare për komunën, si dhe marrjen e vlerës së dobët për parane e dhënë. Kontrolllet e certifikimit kanë dështuar në parandalimin e këtyre pagesave.

**Rekomandimi 12** Kryetari duhet të siguroj që furnizimet do të bëhen vetëm me artikujt e kontraktuar, dhe me raport të pranimit nga menaxheri i kontratës, kurse certifikuesi duhet të shtoj kontrolllet me rastin e verifikimeve të dokumentacionit dhe të siguroj se janë përmbushë të gjitha kushte ligjore që pagesa të certifikohet.

#### Çështja 13 - Dobësitë në marrëveshjet kontraktuese - Prioritet i lartë

**E gjetura** Për projektin "Kryerja emergjente<sup>7</sup> në viset rurale në fshatin Vllahi" komuna ka kontraktuar Operatorin Ekonomik (OE) "UNITETI" sh.a. Kontrata ka qenë valide deri më 11.03.2015. Pas kësaj periudhe, komuna ka vazhduar kontratën me të njëjtin OE deri më 15.11.2015 por pa procedura të prokurimit. Megjithatë, OE ka vazhduar me punime gjatë kësaj periudhe. Për më tepër, komuna nuk ka kryer pagesën (18,064€) tek OE i kontraktuar, por tek një nënkontraktor i tij.

Po ashtu, edhe për projektin "Menaxhimin e mbeturinave te egra, larja, fshirja dhe mirëmbajtja dimërore e rrugëve në qytetin e Mitrovicës", komuna ka kontraktuar (OE) KRM "UNITETI". Megjithatë, komuna ka hyrë në marrëveshje jo të rregullt me nënkontraktuesit e OE, duke kryer edhe pagesat (42,129€ dhe 5,732€) direkt kompanive të nën kontraktuara në marrëveshje.

<sup>7</sup> Mirëmbajtja e rrugëve, larja dhe fshirja e rrugëve dhe shesheve e trotuareve, deblokimi i rrjeteve të kanalizimit fekal në qytet, pastrimi i pusetave etj.

**Rreziku** Komuna ka dështuar të zbatoj kërkesat e rregulloreve të prokurimit, dhe për pasoj, në mënyrë të paligjshme ka vazhduar afatin e kontratës. Po ashtu, pagesat e kryera në llogari të nënkontraktorëve janë të parregullta dhe lënë të hapur mundësinë që kontraktori kryesor të kërkoj sërish kryerjen e këtyre pagesave në llogarinë e tij.

**Rekomandimi 13** Kryetari duhet ta shqyrtoj pse kërkesat ligjore nuk janë përmbushur në këto raste dhe të shtoj kontrollet për të siguruar se situata të tilla nuk do të përsëriten dhe janë respektuar të gjitha kërkesat e legjislacionit në fuqi.

#### Çështja 14 - Dobësitë tjera në fushën e prokurimit - Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna ka lidhur kontratë kornizë për projektin “ Shërbimet e telefonisë mobile për komunë dhe institucione tjera komunale” në vlerë prej 65,147€. Te deklarata e nevojave dhe e përcaktimit të disponueshmerisë së fondeve vlera ishte 60,000€. Raporti i vlerësimit të tenderëve nga komisioni, është e plotësuar në formë elektronike dhe me gabime, jo në përputhje me kërkesat e Dosjes së tenderit, si dhe përzgjedhja është bërë për operatorin me çmim më të lartë.

Komuna ka zhvilluar procedurat e prokurimit për Projektet “Furnizim me farë misri dhe pleh artificial” (7,000€); “ Furnizim me shoqëri të bletëve dhe Koshere ” (4,625€); “Furnizim me material administrativ shpenzues për zyre” (75,000€). Komuna nuk ka bërë zotimin e mjeteve para nënshkrimit të këtyre kontratave.

Po ashtu, për projektin “Furnizim me ushqim dhe pije” për Qerdhe të fëmijëve, ka zhvilluar procedurat e kuotimit të çmimeve për furnizime në vlerë prej 2,942€ pa zotim të mjeteve dhe raporti i vlerësimit të ofertave nuk është nënshkruar nga komisioni i vlerësimit.

**Rreziku** Mos zotimi i mjeteve para kontratës mund të ketë implikime buxhetore gjatë realizimit të kontratës, dhe në mungesë të mjeteve, të rris obligimet ndaj OE dhe të pasoj me gjoba ndëshkuese. Në anën tjetër, mos nënshkrimi i raportit të vlerësimit, dhe mos vlerësimi real i ofertave sipas kriterëve të kërkuara me dosje të tenderit, rrit rrezikun e përzgjedhjes së operatorit ekonomik të papërgjegjshëm dhe me çmim të pafavorshëm.

**Rekomandimi 14** Kryetari duhet të shtoj kontrollet gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, t'i përmbahet planifikimeve dhe të siguroj fondet para hyrjes në obligime. Gjithashtu, të siguroj se gjatë vlerësimit të tenderëve, Komisioni t'iu përmbahet kërkesave të dosjes së tenderit dhe vlerësimi të kryhet dhe të pasohet me raporte formale të nënshkruara nga komisioni.

### 3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti i planifikuar për këtë kategori ishte 610,995€, ndërsa ishin shpenzuar 589,308€, apo 96% e buxhetit. Shpenzimet kryesisht kishin të bëjnë me mbështetje të aktiviteteve kulturore, mbështetje të fermerëve, sportit dhe çështjeve gjinore, si dhe personat fizik si përfitues individual në gjendje të vështirë sociale-ekonomike.

#### Çështja 15 - Mangësi në rregulloren për subvencione - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Komuna ka rregullore të brendshme për ndarjen e subvencioneve, që përcakton vlerën e ndarjes së subvencioneve, mirëpo jo edhe sa herë të njëjtit personat fizik/juridik mund të subvencionohen brenda vitit, duke bërë që disa organizata joqeveritare të subvencionohen disa herë brenda vitit dhe për vite me radhë.

Për organizatën joqeveritare SHKA "AD-LIBIDUM" kemi vërejtur që tri herë gjatë vitit është subvencionuar në vlerë totale 3,095€; për "Shoqatën e gjahtarëve për trajtimin e qenve endacak në zonat urbane dhe rurale të Komunës së Mitrovicës" gjashtë herë në vlerë 8,965€; "Zëri i prindërve" pesë herë në vlerë 5,510€; "Shoqata e Artisteve Figurativ" katër herë në vlerë 7,190€; dhe "Subvencion për person privat" pesë herë në vlerë 3,090€. Vendimet janë nënshkruar nga kryetari, edhe pse janë në pagesa të ndara, por kur bëhet fjalë për të njëjtin përfitues, këto raste duhet të trajtohen përmes komitetit për politikë dhe financa, ose të sqarohen në rregulloren e brendshme<sup>8</sup>.

**Rreziku** Aprovimi i pagesave nga komuna, të cilat në total të shumave të paguara kalojnë vlerën 2,000€, rritë rrezikun që të cenohet e drejta e kërkuësve të tjerë për subvencionim.

**Rekomandimi 15** Kryetari të konsideroj mundësinë e plotësimit/ndryshimit të rregullores ekzistuese në mënyrë që të përcaktohen kritere shtesë lidhur me limitet për dhënien e subvencioneve, në mënyrë që mundësia për përfitimin e subvencioneve të jetë e arsyeshme.

<sup>8</sup> Sipas rregullores së brendshme, subvencionet deri në 2000€ ipen me vendim të kryetarit, mbi këtë vlerë duhet të kalojnë përmes Komitetit për Politikë dhe Financa.

### 3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,041,211€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 2,518,530€. Ato kanë të bëjnë me investime në ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe objekteve të ndryshme kapitale.

#### Çështja 16 - Regjistrimet në kode të gabuara ekonomike- Prioritet i lartë

- E gjetura** Nga kategoria e investimeve kapitale është bërë pagesë në vlerë prej 34,930€ për largimin e deponive ilegale, pagesë e cila do të duhet të kategorizohet në mallra dhe shërbime.
- Rreziku** Pagesat nëpër kategoritë jo përkatëse, paraqesin një pasqyrim të gabuar të shpenzimeve, dhe rrisin rrezikun që komuna ta mbivlerësoj një kategori dhe ta nënvlerësoj tjetrën.
- Rekomandimi 16** Kryetari duhet të siguroj që planifikimet për shpenzime të bëhen konform kodeve ekonomike adekuate të ndara për kategori.

#### Çështja 17 - Dobësitë në procedurat e prokurimit - Prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna ka disa kontrata kornizë që janë lidhur për kryerjen e shërbimeve apo furnizimeve. Në katër kontrata është i caktuar vetëm çmimi për njësi dhe nuk ka vlerë të caktuar për përmbushjen e kontratës për furnizime/kryerjes së punëve. Në një rast nuk është caktuar menaxheri për mbikëqyrjen e kontratës. Gjithashtu, në kontratën "Studimi i fizibilitetit të parkingut nëntokësor dhe mbitokësor te ish Kosovatrasi", disa kritere nuk janë plotësuar tek fituesi si: vërtetimi tatimor ishte më i vjetër se tre muaj, nuk është caktuar menaxheri i kontratës, plani i menaxhimit të kontratës dhe komisioni vlerësues ishte caktuar nga zyra e prokurimit e jo nga Zyrtari Kryesor Administrativ.
- Rreziku** Gjetjet më lart flasin për aplikimin e kontroleve të dobëta në procesin e prokurimit. Mungesa e vlerës së përcaktuar për projektin në kontratë rrit rrezikun që të bëhen shpenzime të pakontrolluara dhe jashtë ndarjeve buxhetore. Po ashtu, mungesa e menaxherit të kontratës, rrit rrezikun që kontratat të mos zbatohen sipas marrëveshjeve të kontraktuara.
- Rekomandimi 17** Kryetari duhet të sigurohet që kontratat kornizë përveç çmimeve për njësi, të kenë edhe vlerën totale të përafërt të projektit në mënyrë që të evitohen parregullsitë e shfrytëzimit të mjeteve. Po ashtu, secila kontratë të ketë menaxherin e kontratës, planin për menaxhimin e kontratës dhe komisionet vlerësuese të caktohen nga Zyrtari Kryesor Administrativ.



**Çështja 18 - Parregullsitë në pagesa - Prioritet i lartë**

- E gjetura** Komuna ka pranuar faturën (5,497€), nga operatori ekonomik për punët e kryera pa kontratë ndërmjet komunës dhe OE. Në anën tjetër, nuk kishte raport për kryerjen e punëve të faturuara. Kjo ka rezultuar në mos zotim të mjeteve për pagesë. Si pasojë, komuna nuk ka kryer pagesën, megjithatë, pagesa është ekzekutuar direkt nga Thesari.
- Rreziku** Pranimi i faturave për projekte të pa kontraktuara dhe pa zotime të mjeteve, ka ndikuar që komuna të hyjë në obligime të cilat kanë implikime buxhetore. Po ashtu, rritë rrezikun e keqpërdorimit të buxhetit të komunës dhe në kundërshtim me rregulloren financiare 01/2013 për shpenzimin e parasë publike.
- Rekomandimi 18** Kryetari duhet të shtoj kontrollet në shfrytëzimin e parasë publike, dhe të siguroj që asnjë faturë të mos pranohet në mënyrë të parregullt, pa pasur kontratë të nënshkruar dhe në pajtim me rregullat financiare.

## 3.2 Pasuritë

### 3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Komuna edhe më tutje nuk ka arritur të siguroj një regjistër gjithëpërfshirës dhe të plotë për pasuritë jo financiare. Sfidat në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive kanë rezultuar në nënvlerësim material të vlerave të pasurive në shpalosjen e PVF-ve sidomos për sa i përket tokave dhe disa ndërtesave.

**Çështja 19 - Mangësi në menaxhimin e pasurive - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Komuna ende nuk ka procedura të brendshme për menaxhimin e pasurisë sipas kërkesës së rregullores së thesarit 02/2013. Komisioni i formuar për inventarizim ka bërë vetëm verifikimin e pasurisë ekzistuese, por jo edhe vlerësimin për pasuritë e vjetërsuara, të dala nga përdorimi apo tjetërsimin e tyre. Po ashtu, komuna ka formuar edhe komisionin për identifikimin e pasurive, e cila ka bërë vetëm pjesërisht identifikimin e pasurive jo financiare.

Sistemi i e-pasurisë ende nuk është në funksion të plotë, regjistrimi i stoqeve për drejtorinë e Arsimit dhe të Shëndetësisë nuk është kryer.

---

**Rreziku** Mungesa e procedurave të brendshme për menaxhimin e pasurisë rrit rrezikun që komuna mos të ketë nën kontroll të gjitha pasuritë e saj dhe të ketë mangësi në raportim. Komisionet përkatëse duhet të dalin me raporte përfundimtare dhe të raportojnë për gjendjen e pasurisë, në mënyrë që të evitohet rreziku i keqpërdorimit apo humbjes së pasurisë.

**Rekomandimi 19** Kryetari duhet të sigurohet që të kryhet identifikimi dhe vlerësimi i pasurisë së komunës dhe të ketë regjistra të plotë të pasurisë. Komisioni i inventarizimit duhet të krahasoj gjendjen kontabël me gjendjen faktike dhe të verifikoj ekzistencën fizike të pasurive dhe stoqeve. Aty ku vërehen mospërputhje, komisioni përmes raportit përfundimtar duhet t'i raportoj menaxhmentit. Rezultatet e regjistrimit duhet të azhurnohen edhe në regjistrat kontabël. Gjithashtu, të regjistrohen të gjitha pasuritë e komunës nën 1000€ në sistemin e-pasuria, duke përfshirë edhe Shëndetësinë dhe Arsimin.

#### Çështja 20 - Ndërtimi i shtëpive për raste sociale dhe të tjera - Prioritet i lartë

**E gjetura** Nga investimet kapitale, komuna bën ndërtimin e shtëpive dhe furnizimin me material ndërtimor për rastet sociale dhe ndodhjes së ndonjë fatkeqësie, mirëpo këto nuk figurojnë në asnjë nga regjistrat e komunës (si investime në vijim). Vlera e këtyre pagesave në vitin 2016 arrin 225,555€. Nuk ka të dhëna në dispozicion se në çfarë faze ka arritur ndërtimi, nëse shtëpitë janë në ndërtim e sipër, janë përfunduar, apo janë dhënë në përdorim.

**Rreziku** Komuna ushtron kontrole të dobëta në këtë fushë. Dhe, niveli aktual i kontroleve, nuk ofron asnjë siguri se fondet e shpenzuara po arrijnë vlerën për para. Fakti se mungojnë raportet e progresit lidhur me ndërtimin e këtyre shtëpive, bart rrezikun që materialet e shpërndara për ndërtim të manipulohen, madje edhe të keqpërdoren.

**Rekomandimi 20** Kryetari duhet të merr masa të menjëhershme që përmes raporteve të zyrtarëve përgjegjës të vlerësoj në mënyrë gjithëpërfshirëse shkallën e progresit në ndërtimit të këtyre shtëpive, arsyeshmërinë e shpenzimeve, tejkalimet, nevojat për fonde shtesë dhe pajtueshmërinë e shpenzimeve me rregulloret financiare. Shtëpitë e banimit duhet të regjistrohen si investim në vijim në regjistrat e pasurisë së komunës deri në përfundimin e projektit dhe pranimit teknik. Pas përfundimit të projektit, duhet të bëhet transferi i pasurisë tek përfituesit.

---

### 3.2.2 Të arkëtueshmet

Llogaritë e Arkëtueshme (LL/A) janë faturimet të cilat komuna nuk ka arritur t'i realizoj si të hyra vetjake nga shërbimet e bëra dhe tatimit në pronë.

---

#### Çështja 21 - Sfidat në menaxhimin e LL/A - Prioritet i Lartë

- E gjetura** Lista e debitorëve ndaj komunës, sipas të dhënave të PVF-ve është 8,387,000€ e cila ka shënuar një rritje të lehtë nga viti i kaluar (8,153,000€). Pjesa më e madhe e këtyre llogarive kanë të bëjnë me tatimin në pronë (4,918,000€), tarifat komunale (3,235,000€), qiraja komunale (127,000€), taksat e urbanizmit (88,000€) dhe të tjera (18,000€). Komuna ka shlyer borxhet e viteve paraprake, mirëpo nuk ka regjistër të LL.A të shlyera.
- Rreziku** Mos arkëtimi i të hyrave të ngarkuara mund të ndikoj në pamundësinë e komunës për t'i përmbushë planet e shpenzimeve. Po ashtu, të reduktoj numrin e projekteve potenciale që do të financoheshin nga të hyrat vetjake. Mos ekzistenca e listave të faljes së borxheve tregon pasiguri se procesi është kryer sipas ligjit mbi faljen e borxheve dhe paraqet një gjendje joreale të borxheve të falura dhe në pasqyrat financiare.
- Rekomandimi 21** Kryetari duhet ta analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e borxheve, si dhe të propozoj masa dhe procedura plotësuese për të reduktuar sa më shumë gjendjen e këtyre llogarive. Po ashtu, duhet të rishikohen listat e faljes së borxheve dhe të veprohet konform rregullave të përcaktuara.

---

### 3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve për vitin 2016 ishte 1,072,653€. Kjo vlerë bartet si detyrim në vitin vijues për tu paguar.

---

#### Çështja 22 - Rritja e obligimeve - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Obligimet e papaguara, krahasuar me vitin 2015 (462,695€) ishin rritur për 609,958€. Komuna ka një trend negativ të kryerjes së obligimeve. Obligimet e papaguara janë rritur në të gjitha fushat ekonomike: mallra dhe shërbime 496,699€, komunal 62,906€, subvencione 96,624€ dhe investime kapitale 416,424€. Kjo situatë ka rezultuar si pasojë e menaxhimit jo të duhur të komunës.

**Rreziku** Fakti që komuna ka obligime të bartura mbi një milion euro, është një tregues i dobët i disiplinës financiare. Kjo rrit rrezikun që këto obligime të çrregullojnë bilancin buxhetor të komunës dhe të njëjtat të paguhen vitin e ardhshëm, duke rrezikuar realizimin e projekteve të parashikuara për vitin 2016.

**Rekomandimi 22** Kryetari duhet të analizoj në baza mujore ecuritë buxhetore dhe të balancoj nevojat me fondet disponibile dhe të parandaloj të gjitha veprimet që shpiejnë në krijimin e obligimeve pa sigurimin paraprak të fondeve.

---

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofroj mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofroj mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikoj opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutoj çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktoj nëse është e nevojshme të modifikoj opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikoj opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazoj një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazoj një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultoj në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkoj nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikoj edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregoj se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregoj se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2. Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura përfshirë rreziqet domethënëse të identifikuar. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime.		Pjesërisht Në PVF edhe këtë vit ka pasur gabime në zërat e paraqitur.	
2.Qeverisja	Kryetari duhet të sigurojë një planifikim të qartë të prokurimit, ku do të specifikohen veçmas shërbimet, mallrat dhe punët e planifikuara të cilat i nënshtrohen ligjit të prokurimit. Për të kryer një planifikim të mirë të prokurimit zyrtarit të prokurimit do t'i nevojitet bashkëpunimi i ngushtë me departamentin e buxhetit dhe departamentet tjera. Më tutje, të siguroj që me vendim të caktoj komisionin për pranimin e mallrave në pajtim me rregulloren Nr.02/2013, si dhe raporti i pranimit të mallit të jetë në pajtim me rregullën financiare Nr. 01/2013 MF-shpenzimi i parave publike.		Pjesërisht, procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut ende nuk janë vendosur.	
2.3Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin e plotë të rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuar me shkallë të lartë rreziku dhe brenda afateve të përcaktuara.		Prej 25 rekomandimeve vetëm pesë janë zbatuar.	



2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë aktive. Një proces rishikimi duhet të aplikohet nga auditimi i brendshëm për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.	Është zbatuar		
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë që pasi të jetë hartuar regjistri i rreziqeve, është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhoj këtë proces dhe do të raportoj në baza të rregullta mbi rreziqet.			Nuk është zbatuar, nuk kanë listë të rreziqeve.
2.5.2 Raportimi Menaxherial	Kryetari duhet të siguroj se cilësia e kontrolleve dhe mbikëqyrjes buxhetore duhet të rishikohet në mënyrë kritike dhe sistematike për të siguruar se janë vendosur kontrole të përshtatshme në fushat ku janë identifikuar dobësitë.		Pjesërisht, tek fusha e investimeve kapitale janë përsëritur dobësitë sa i përket planifikimit dhe realizimit të buxhetit.	
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të ndërmarr veprime konkrete dhe të vazhdueshme, të reagoj me kohë në gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm, ndërsa komiteti i auditimit të bëjë një plan pune ku do t'i specifikoj agjendat e punës dhe temat që do t'i trajtoj gjatë vitit. Në procesverbalet e takimeve, të nxjerrë konkluzione të qarta për menaxhmentin lidhur me çështjet e auditimeve të brendshëm.			Nuk është zbatuar, Menaxhmenti i komunës nuk kishte bërë plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NJAB, dhe nuk janë vërejtur veprime konkrete të komitetit të auditimit.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Kryetari duhet të sigurohet që me rastin e planifikimeve buxhetore, të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i burimeve potenciale të hyrave, dhe të përcaktoj opsione praktike për përmirësimin e ekzekutimit për vitin 2016. Një monitorim sistematik i trendeve buxhetore do të rriste mundësitë për një performancë më efektive.			Nuk është zbatuar, pagesat përmes vendimeve gjyqësore nga kategoria e investimeve kapitale, për shkak që komuna ka hyrë në obligime pa zotimet e mjaftueshme të mjeteve.
3.4 Prokurimi	Kryetari duhet t'i shqyrtoj arsyet pse rastet e mësipërme në procesin e prokurimit kanë ndodhur, dhe të forcoj kontrollet e prokurimit në të gjitha fazat e procesit. Një qasje e përmirësuar nevojitet sidomos në planifikimin fillestar të nevojave, dhe në shmangien maksimale të procedurave për kontrata me vlera të vogla dhe minimale, përveç rasteve kur kjo vlerësohet e domosdoshme. Gjithashtu, duhet të siguroj se para inicimit të procedurave të prokurimit të nënshkruhet deklarata e disponueshmërisë së mjeteve, të emëroj menaxherët e kontratave dhe të bëjë aprovimin e komisioneve vlerësuese, ashtu siç parashohin rregulloret e prokurimit.		Pjesërisht, por ende ka pas raste ku nuk është caktuar menaxheri për mbikëqyrjen e kontratës	
	Kryetari duhet të siguroj respektimin e çmimeve kontraktuale, si dhe kontrollet e certifikimit të pagesave dukshëm të forcohen dhe të parandalojnë të gjitha pagesat e tilla.		Pjesërisht, por janë hasur disa raste që certifikusi ka bërë lëshime.	
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet që parashihen procedura të prokurimit, ato të zbatohen në mënyrë strikte, siç parashihet me Ligjin e Prokurimit Publik.			Nuk është zbatuar. Janë vazhduar kontratat kornizë pa procedura e kërkuara .

	Kryetari duhet të sigurojë se nuk do të bëjë pagesa para se të konfirmohet se punimet apo shërbimet janë kryer. Pagesat duhet të jenë të dokumentuara me fatura dhe raporte të konfirmuara për pranimin e punëve/shërbimeve. Aspekti i mbikëqyrjes dhe raportimit të detyrimeve që dalin nga këto marrëveshje, duhet të jetë subjekt i shqyrtimeve të rregullta nga menaxhmenti i komunës. Për të eliminuar rrezikun për dështimin e këtyre marrëveshjeve, ne do të sugjerim që praktikat e tilla të pagesave të ndërpriten.		Pjesërisht është zbatuar , nga operatori ekonomik është pranuar fatura për punët e kryera pa kontratë .	
3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet) Pagat	Kryetari duhet të siguroj që arsyet e gabimeve në ekzekutimin e pagave duhet të rishikohen, si dhe të shtojë kontrollet tek menaxhimi i personelit në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten. Pagesat e kryera në mënyrë të pa drejtë, duhet të t'i kthehen buxhetit të komunës.	Është zbatuar		
	Kryetari duhet që para fillimit të vitit shkollor të analizoj nevojat për numrin e stafit të domosdoshëm në sektorin e arsimit, dhe në rast të barrierave ligjore, çështjen ta diskutoj edhe me Ministrinë e linjës dhe Qeverinë, në mënyrë që të siguroj se stafi i angazhuar nuk do të mbetet jashtë listës së pagave.	Është zbatuar		
	Një shqyrtim sistematik i Dosjeve të Personelit duhet të ndërmerret, për të siguruar se i tërë dokumentacioni i nevojshëm është përfshirë brenda një periudhe të specifikuar kohore, si dhe të gjitha pagesat janë të mbështetura. Vlerësimi i punëtorëve duhet të kryhet të paktën një herë në fund të çdo viti shkollor.		Pjesërisht është zbatuar, ka pas rast që pagesave jashtë orari nuk janë të kompletuara me vendime.	
	Kryetari duhet të shtoj kontrollet tek shëndetësia në mënyrë që pagesat e shpenzimeve të udhëtimit të bëhen nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, duke i dokumentuar ato sipas rregulloreve të thesarit.	Është zbatuar		

3.5.3 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari duhet të siguroj që të vendosen kontrole me rastin e pagesave, në mënyrë që të gjithë artikujt të paguhen sipas çmimeve të kontraktuara.		Pjesërisht e zbatueshme, se rregullorja e brendshme se qartëson sa herë të njëjtit personat fizik/juridik mund të subvencionohen brenda vitit .	
	Kryetari duhet të siguroj që kriteret e përcaktuara me Rregulloren për subvencione zbatohen në tërësi. Në të kundërtën, subvencionet nuk duhet të jepen.			Nuk është zbatuar, ka mangësi të kriterëve në zbatimin e rregullores.
3.6 Të hyrat	Kryetari duhet t'i rishikojë kontratat dhe marrëveshjet për qiratë, si dhe procedurat ekzistuese në mbledhjen e taksave dhe të merr masa për inkasimin e të gjitha borxheve të mbetura nga qiratë. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë duhet të merren pronat e dhëna, dhe përmes ankandit publik t'u ofrohen shfrytëzuesve tjerë potencial që kryejnë pagesat me kohë të qirave.			Nuk është zbatuar , për komplekset banesore të dhëna me qira , kontratat e tyre nuk janë verifikuar nga viti 2011.
	Kryetari duhet të sigurojë se bëhet identifikimi i pengesave në inkasimin e tatimit në pronë dhe të krijoj një plan konkret me të gjitha masat përcjellëse për të maksimizuar nivelet e inkasimit nga tatimi në pronë	Është zbatuar		
	Kryetari të sigurojë që Departamenti i Financave të ndërtoj një bazë të dhënash (program) dhe të sistemoj të gjithë informacionin e duhur për bizneset që aktivisht operojnë brenda territorit të komunës. Gjithashtu, duhet të aplikohen masa efektive që taksat e biznesit të inkasohen sipas periudhave të vitit, duke mos injoruar edhe borxhet e mëhershme.			Nuk është zbatuar, baza jo e plotë e të dhënave me ushtruesit e veprimtarisë së bizneseve,

	Kryetari duhet të rishikoj rastin e këtyre pagesave, dhe të gjithë kandidatëve që kanë paguar më tepër se shumat e përcaktuara me U/A dhe rregullore, t'u bëhet rimbussim.		Pjesërisht e zbatueshme, pasi që rastet nuk janë përsëritur, rimbursimi nuk është bërë..	
3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të siguroj që sa më parë komisioni të bëj vlerësimin e drejtë dhe të plotë të të gjithë pasurive që janë në pronësi të komunës, dhe të monitoroj rezultatet e vlerësimit. Po ashtu, për të pasur një evidencë të saktë të stoqeve, të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme me vlera nën 1,000€ të bëhen përmes sistemit e-pasuria.			Nuk është zbatuar. Komuna ende nuk ka procedurë të brendshme për menaxhimin e pasurisë sipas kërkesës së rregullore të thesarit 02/2013
3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari duhet të inicioj një proces rivlerësimi (shqyrtimi), ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, vlefshmërinë e borxheve individuale të shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).			Nuk është zbatuar, Mos ekzistenca e listave të faljes së borxheve tregon pasiguri se procesi është kryer sipas ligjit mbi faljen e borxheve.
3.7.3 Trajtimi i borxheve	Për t'iu shmangur hapjes së kontesteve gjyqësore dhe ekzekutimit të pagesave direkte nga Thesari, kryetari duhet të trajtoj me kujdes këtë situatë, dhe të merr masat e duhura që të planifikoj buxhetin për kryerjen e borxheve ndaj furnitorëve dhe mësimdhënësve si dhe të parandaloj hyrjen në obligime të reja pa zotimin paraprak të fondeve.			Nuk është zbatuar, janë rritë obligimet.
Numri i rekomandimeve		5	10	10

## Shtojca IV: Letërkonfirmimi



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës**  
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

<b>DATË/A:</b>	25.04.2017
<b>REFERENC-Ë:</b>	01-030/01-0032439/17
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Qerkin Morina, Ndhmës Auditues Përgjithëse
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Z. Agim Bahtiri
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Letër Konfirmimi



## LETËR E KONFIRMIMIT

I nderuar,

Ne konfirmojmë se,

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Mitrovicës, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Me respekt

Kryetari i Komunës së Mitrovicës,

**Agim Bahtiri**